



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:083372

Datë: 27.12.2022

Numri i dokumentit: 03801881

P.nr.1/2021

NË EMËR TË POPULLIT

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdiqaj, bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit S. H. nga fshati ...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Sulmi nga neni 184 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.286/2020 të datës 19.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datë 14.12.2022, në të cilin prezent ishin prokurori i shtetit Halim Borovci, i akuzuari S. H. dhe i dëmtuari O. M., më datën 15.12.2022 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa më datën 27.12.2022, e përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

- I pandehuri **S. H.**, nga babai Rr. dhe nëna H., mbiemri i vajzërisë T., i lindur me datë ... në fshatin ... – Komuna Skenderaj, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer mesme, i martuar – baba i tre (3) fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

- **SEPSE** : Me datën 31.01.2020 rreth orës 16:40, në fshatin ... – Komuna Skenderaj, para restorantit “P.”, me vetëdije ka përdorur dhunën ndaj personit O. M., ashtu që paraprakisht edhe atë duke ia bërë me dorë e ka thirrur që të dalë nga restoranti i cekur për t’i sqaruar raportet lidhur me kthimin e borxhit, e në momentin kur i dëmtuari duke mos ia vënë veshin fjalëve të tij ka hyrë në automjet, iu ka afruar të njëjtit, me dorë e ka nxjerrë nga automjeti, ka filluar ta godasë nëpër trup e pastaj e ka zvarritë nëpër tokë.

- **Me këtë ka kryer veprën penale–Sulmi nga neni 184 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore dhe neneve : 4, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-së, e lidhur me nenet 450 par.2 nënpar.2.6, 453 par.1, 463 par.1 dhe 2 si dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin :

- E G J Y K O N -

I.- Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda kohës së verifikimit prej një (1) viti nga dita kur aktgjykimi të merrë formën e prerë nuk kryenë vepër tjetër penale.

II.- Obligohet i pandehuri që t`i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20.00 € (njëzetë euro) si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III.- Pala e dëmtuar O. M. nga fsh...-Komuna Skenderaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregulltë civil.

- A r s y e t i m -

- Rrjedha e çështjes –

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm në këtë gjykatë me datë 30.10.2020 ka parashtruar aktakuzën e saj PP.II.nr.286/2020 të datës 19.10.2020, kundër të pandehurit S. H. nga fshati ...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, dhe kundër të pandehurit O. M. nga fshati L. – Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale – Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

- Gjykata në këtë çështje penale konform dispozitës ligjore nga neni 36 par.1 dhe par.2 të KPP-së, ka marrë Aktvendim P.nr... të datës 26.11.2020, me të cilin ka veçuar procedurën penale për të pandehurin S. H. nga fshati ... – Komuna Skenderaj, ashtu që ndaj këtij të pandehuri është udhëhequr procedurë e veçantë penale dhe lënda ka marrë numër të ri.

- Gjykata në këtë çështje penale me datë 14.12.2022, e ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, e cila ka qenë e hapur për publikun, në të cilin kanë prezantuar prokurori i shtetit Halim Borovci, i dëmtuari O. M.

dhe i pandehuri S. H., ashtu që të pandehurin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se në këtë çështje penale i pandehuri ka deklaruar se dëshiron të mbrohet vetë.

- Gjykata edhe të dëmtuarin hollësisht e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale në cilësinë e palës së dëmtuar në këtë çështje penale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike ka deklaruar se nuk e paraqet në këtë procedurë penale ndërsa, i është bashkëngjitur ndjekjes penale.

- Vlerësimi i pranimit të fajësisë –

- Meqenëse i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor ka hequr dorë nga leximi i aktakuzës, gjykata të njëjtin e ka njoftuar hollësisht me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, ashtu që ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe i njëjti u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, deklaroi se pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, pas njoftimit nga gjykata me favoret dhe disfavoret e pranimit të fajësisë, shprehi keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet e tilla, lidhur me veprimet e tij është penduar thellësisht, për çka sinderisht kërkoi falje, më tej ka theksuar se, personalisht në këtë çështje penale është dëmtuar duke marrë lëndime trupore nga tani i dëmtuari O. M., se me të njëjtin është pajtuar dhe se personalisht ia ka falur.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e kërkojë mendimin nga prokurori i shtetit, i cili me këtë rast deklaroi se, meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë të lirë dhe vullnetare, pa presion dhe pse është njoftuar me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë e çka ka konfirmuar dispozitivin e aktakuzës, respektivisht dispozitivin I, e cila aktakuzë është e mbështetur edhe në provat tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe i kërkojë gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe dënojë sipas ligjit, njëherë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësues dhe rënduese e që dënimi të jetë në proporcion me dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

- Gjykata po ashtu kërkojë mendimin edhe nga pala e dëmtuar i cili me këtë raste deklarojë se, e përkrahë fjalën e dhenë nga prokurori i shteti, po ashtu kërkojë nga gjykata që ta pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit dhe i dëmtuari, gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim të nenit 326 par.2 e lidhur me nenin 248 par.4 të KPP-

së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari lidhur me veprën penale e cila i vihej në barrë sipas kësaj aktakuzë ngase, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve e më pas me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

- Fjala përfundimtare e palëve -

- **Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare** deklaroi se, mbetet në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit S. H. nga fshati ... – Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, e që të njëjtat mbështetën në aktakuzë, në provat materiale nga të cilat edhe është ngritur aktakuzë, kjo u vërtetua edhe nga vetë pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit andaj, i propozoi gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe t'i merrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj tij.

- **I dëmtuari në fjalën e tij përfundimtare** ndër të tjera deklaroi se, e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit po ashtu ka mbetur pranë deklarimeve të theksuara në shqyrtim gjyqësor.

- **I pandehuri në fjalën e tij përfundimtare** ndër të tjera deklaroi se, mbetet pranë deklarimeve të sipërtheksuara, duke i propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj tij të ketë parasysh faktin se është mbajtës kryesor i familjes, i papunë, ashtu që ndaj tij të shqiptojë një dënim sa me të butë.

- Gjendja faktike e vërtetuar –

- Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para se gjithash nga pranimi i fajësisë nga i pandehuri, pranimi i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të propozuara nga Prokuroria e shtetit siç janë : Raporti i oficerëve policor Nr... të datës 31.01.2020 dhe datë 01.02.2020, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarit (dhënë në cilësinë e dëshmitarit)-O. M. Nr...- i datës 04.02.2020 dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Procesverbalët mbi marrjen në pyetje të dëshmitareve-E. S., H. S. dhe B. B., Nr... të datës 31.01.2020 dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Procesverbalet mbi marrjes në pyetje të të pandehurit-S. H. Nr... i datës 31.01.2020 dhe datë 03.02.2020 dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Akt

ekspertimi mjeko-ligjor Nr.referencë ... i datës 17.06.2020 në emër të të pandehurit S. H., punuar nga Dr.V. K. si dhe nga vështrimi në të gjitha shkresat tjera të lëndës.

- Në bazë të gjendjes faktike të pakontestueshme, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të pandehurit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale-Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, ngase i njëjti më datën 31.01.2020 rreth orës 16:40, në fshatin ... – Komuna Skenderaj, para restorantit “P.”, me vetëdije ka përdorur dhunën ndaj personit O. M., ashtu që paraprakisht edhe atë duke ia bërë me dorë e ka thirrur që të dalë nga restoranti i cekur për ti sqaruar raportet lidhur me kthimin e borxhit, e në momentin kur i dëmtuari duke mos ia vënë veshin fjalëve të tij ka hyrë në automjet, iu ka afruar të njëjtit, me dorë e ka nxjerrë nga automjeti, ka filluar ta godasë nëpër trup e pastaj e ka zvarritë nëpër tokë, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit –

- Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të akuzuarn si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjithashtu, rrethanë tjetër lehtësuese gjykata mori rrethanën e tij personale se i njëjti është baba i tre (3) fëmijëve, mbajtës kryesor i familjes, pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, premtimin gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe se nuk do të përsërisë veprime të tilla, se me të dëmtuarin është pajtuar, si dhe faktin se në këtë rast nga veprimet e të dëmtuarit duke përdorur mjetin e rrezikshëm-shufrën metalike, të pandehurit i kishte shkaktuar lëndime të lehta trupore në pjesën e regjionit ballor të kokës, shpinës dhe krahëve në të dy duartë me karakter të përkohshëm trupor (shih në shkresat e lëndës :Aktgjykimin dënues të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal P.nr.... datë 30.11.2020, i plotëfuqishëm me datë 21.12.2020, ndaj të dëmtuarit-në cilësinë e të pandehurit O. M.) ndërsa, si rrethanë rënduese për të njëjtin gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes dhe të përgjegjësisë penale të të pandehurit.

- Sipas bindjes së gjykatës, duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të pandehurit i shqiptojë dënim me kusht dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë

kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest të rregulltë civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.1/2021 me datë 27.12.2022.

Procesmbajtësja,
Florije Gucati

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatos Sejdijaj

- KËSHILLË JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.